



BASHKIA
TIRANË

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA TIRANË
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E BURIMEVE NJERËZORE
DREJTORIA E PROCEDURAVE TË BURIMEVE NJERËZORE

Lënda: Hapja e aplikimeve për ekspertë, anëtarë të Komiteteve të Pranimit

Bashkia Tiranë, Drejtoria e Procedurave të Burimeve Njerëzore, në cilësinë e njësisë përgjegjëse për organizimin e procedurave të konkurrimit për plotësimin e vendeve vakante në institucionit, krijon Komitetet e Pranimit, të cilat kryejnë vlerësimin e kandidatëve pjesëmarrës në këto procedura.

Sa më sipër, në zbatim të pikës 5, të Kreut III, të Vendimit nr.243, datë 18.3.2015 të Këshillit të Ministrave, “Për pranimin, lëvizjen paralele, periudhën e provës dhe emërimin në kategorinë ekzekutive”, si dhe pikës 10, të Kreut III, të Vendimit nr. 242, datë 18.3.2015 të Këshillit të Ministrave, “Për plotësimin e vendeve të lira në kategorinë e ulët dhe të mesme drejtuese”, Drejtoria e Procedurave të Burimeve Njerëzore,

NJOFTON

Hapjen e aplikimeve për anëtarët e komiteteve, ekspertë në fushat :

- Shkenca Juridike
- Shkenca Ekonomike
- Auditim
- Shkenca të Bujqësisë dhe Mjedisit
- Shkenca të Natyrës
- Hartim ose menaxhim i projekteve
- Planifikim strategjik
- Shkenca Inxhinierike/Arkitekture
- Shkenca Informatike

Detyrat

Në kuadër të angazhimit në përbërje të Komiteteve të Pranimit, eksperti duhet:

1. Të japë kontributin e tij në përgatitjen e pyetjeve për testimin e fushës së njohurive, të aftësive dhe të cilësive të kërkuara për pozicionin/pozicionet vakant/e;
2. Të propozojë pyetje në kuadër të intervistës së strukturuar me gojë;
3. Të marrë pjesë në procesin e vlerësimit duke qënë objektiv, i paanshëm dhe profesional;
- 4..Të marrë pjesë në shqyrtimin e ankesave të paraqitura nga kandidatët;

Kriteret e kërkua

Aplikantët duhet të plotësojnë **një nga** kriteret e mëposhtme:

1. Të jenë aktualisht prej jo më pak se 5 vitesh në detyrën e pedagogut (të brendshëm ose të jashtëm) në një nga universitetet publike/private apo institucione të tjera të arsimit të lartë.
2. Të kenë të paktën 5 vjet përvojë si ekspertë të licensuar të fushave të sipërpërmendura ose ekspertë që vijnë nga profesionet e rregulluara;

Dokumentacioni, mënyra dhe afati i dorëzimit

Aplikantët duhet të dorëzojnë dokumentat si më poshtë:

1. CV
2. Fotokopje të diplomës;
3. Fotokopje të librezës së punës (të gjitha faqet që vërtetojnë eksperiencën në punë);
3. Vertetim nga universitetet publike / private apo institucione të tjera të arsimit të lartë.
4. Fotokopje të letërnjoftimit (ID);
5. Për ekspertët e licensuar, Fotokopje e Licensës profesionale.

Dokumentacioni i mësipërm duhet të dërgohet në rrugë postare në adresën: Drejtoria e Procedurave të Burimeve Njerëzore, Bashkia Tiranë, Shëtitörja “Dëshmorët e Kombit” nr.2, Tiranë, kodi postar 1001 Shqipëri, ose drejtpërdrejt në Sportelet e Sektorit të Informimit dhe Shërbimeve me Qytetarët pranë Bashkisë së Tiranës brenda datës **30.01.2023**.

Të tjera

Shpërblimi për angazhimin në këtë veprimtari, rregullohet sipas Vendimeve të Këshillit të Ministrave nr.243, datë 18.3.2015 “Për pranimin, lëvizjen paralele, periudhën e provës dhe emërimin në kategorinë ekzekutive”, dhe nr.242, datë 18.3.2015 “Për plotësimin e vendeve të lira në kategorinë e ulët dhe të mesme drejtuese”.

Përzgjedhja dhe komunikimi me aplikantët

Seleksionimi i kandidatave do të kryhet nga Drejtoria e Procedurave të Burimeve Njerëzore, Bashkia Tiranë. Vetëm kandidaturat e përzgjedhura do të kontaktohen.